



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.206/2019

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesues, Gyltene Sylejmani dhe Fejzullah Rexhepi anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares së lartë ligjore Florije Krasniqi duke vendosur përkitazi me ankesën e Organizatës Joqeveritare BIRN dhe Internews Kosova, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, për shkak të bërjes së fushatës zgjedhore me fëmijë, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen me datë 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur me datë 05.10.2019, mori këtë:

VE N D I M

Refuzohet e pabazuar ankesa Anr.206/2019 e datës 03.10.2019, e paraqitur nga Organizata Joqeveritare BIRN dhe Internews Kosova, me seli në Prishtinë, kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës, (LDK), me seli në Prishtinë, për shkak të bërjes së fushatë zgjedhore me fëmijë.

A r s y e t i m

Me datën 03.10.2019, Organizata Joqeveritare BIRN dhe Internews Kosova, ka paraqitur ankesë në PZAP, në të cilën pretendon se me datë 02 Tetor 2019 rreth orës 22:30, në rrjetin social Facebook subjekti politik LDK, kanë publikuar disa fotografi nga tubimi i mbajtur në Komunën e Shtimes. Në këto fotografi të postuara sipas parashtruesit të ankesës shihet se ka pasur fëmijë nen moshën 15 vjeçare. Me këtë veprim kanë bërë shkeljen e Rregullës 13/2013 e Plotësuar me Rregullën 20/2019

Paraqitësi i ankesës në mbështetje të pretendimeve në ankesë, si dëshmi ka bashkangjitur dy fotografi të printuara.

Në përgjigjen në ankesë të datës 04.10.2019, subjekti politik LDK, thekson se

Paneli, pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se:

Ankesa është e pabazuar

PZAP-i, vendimet e tij i bazon në dëshmi qarta dhe bindëse siç është përcaktuar me nenin 117 paragrafi 3 i LZP-së, e që në rastin konkret fotografitë e ofruara nga ankuesi, lidhur me bërjen fushatë me fëmijë për panelin është e paqartë dhe nuk është bindëse për të vendosur ndryshe në këtë rast, ngase në fotografitë e ofruar nga rrjeti social facebook nuk mund të identifikohen shenja apo slogane të subjektit politik LDK në rastin konkret flamuri i Dardanisë i prezantuar në foto nuk e përfaqëson subjektin e pretenduar në ankesë.

Andaj paneli erdhi në përfundim se janë të paqëndrueshme pretendimet-përshkrimet në ankesë, se është shkelur Rregulla 13/2013 neni 5 pika h) nga subjekti politik LDK.

Më këtë rast paneli konsideron se parashtuesi i ankesës, me dëshmitë e ofruara nuk i ka vërtetuar pretendimet e tij në mënyrë që paneli, të merr vendim në favor të parashtuesit të ankesës dhe si të tillë e refuzoi të pabazuar.

Nga arsyet e theksuar me lart e në kuptim të neneve 115 paragrafi 1, neni 117 paragrafi 3 neni 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur me nenin 5 paragrafi 7 i Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, Nr.02/2015, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr.206/2019 më datën 05.10.2019

**Kryesuesi i Panelit
Zyhdë Haziri**



Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.